



SIKA AT WORK

Hidroizolim tarrace në banesë private me membranën e lëngshme Sikalastic[®], Shqipëria Jugore

HIDROIZOLIM TARRACE: Sikalastic[®]-612, Sika[®] Reemat Premium



BUILDING TRUST



SISTEMI ME MEMBRANË TË LËNGSHME SIKALASTIC®



PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti përfshinte restaurimin dhe hidroizolimin e një tarrace me sipërfaqe 140m² të një banese private në Sarandë (Shqipëri e Jugut). Nënshtrësja ekzistuese ishte prej pllakash qeramike. Të gjitha pllakat u hoqën dhe nënshtrësja u rinovua plotësisht duke derdhur llaç çimentoje.

KËRKESAT E APLIKIMIT

Sfida e aplikimit ishte e shumëfishtë, si:

- Sistemi i përzgjedhur i restaurimit dhe hidroizolimit duhej të aplikohet direkt mbi pllakat ekzistuese qeramike.
- Nënshtrësja përfshinte shumë detaje dhe depërtime (dizajn i ndërlikuar)
- Shtresja përfundimtare e hidroizolimit duhet të ketë rezistencë ndaj rrezatimit UV ndërsa paraqet reflektivitet të lartë diellor

KËRKESAT

Aplikuesi kërkoi një sistem hidroizolimi me përgatitje minimale, pajisje specifike dhe aplikim të lehtë tek të gjitha detajet e ndërlikuara, duke qënë në të njëjtën kohë zgjidhje ekonomike. Pronari kërkoi një zgjidhje afatgjatë dhe me kërkesa minimale për mirëmbajtje.


ZGJIDHJA NGA SIKA

Duke patur në konsideratë parametrat e mësipërm, sistemi i propozuar dhe i zgjedhur në fund ishte membrana e lëngshme **Sikalastic®-612**, e përforcuar me rrjetë fibrash qelqi **Sika® Reemat Premium**. **Sikalastic®-612** është një membranë e lëngshme, aplikimi me metodën e ftohtë, poliuretani dhe 1 përbërësi që nuk kërkon përzierje dhe është gati për përdorim. Produkti aplikohet shumë lehtësisht, pa nevojën e pajisjeve specifike dhe është një zgjidhje ekonomike, veçanërisht për rastet e projekteve të restaurimit.

Fillimisht, u bë përgatitja e nënshtrësës me anë të pastrimit dhe heqjes së kores së çimentos, pluhurit dhe grimcave të lira. Gjithashtu, të gjitha fugat e ndërtimit dhe lëvizjes u përgatitën (me pastrim dhe izolim) në mënyrën e duhur.

Pas kësaj procedure u përzgjedh **Sikalastic®-612** në ngjyrë të bardhë për të shërbyer gjithashtu si një veshje reflektive për tarracën me efikasitet energjetik dhe u aplikua mbi të gjithë sipërfaqen në dy shtresa. Midis dy shtresave të **Sikalastic®-612** dhe në të gjithë perimetrin e zonës si dhe tek fugat e ndërtimit, u aplikua rrjeta me fibra qelqi **Sika® Reemat Premium** për përforcimin e shtresave dhe pjesëve thelbësore të sistemit të hidroizolimit.





Sika Albania SHPK
Blv. "Gjergj Fishta", Alpas
Center, kati i 3-të
1000, Tirana, Albania

Contact
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com / info@al.sika.com

BUILDING TRUST

